



# Rregullore e kopshtit 2016



## Kopshti i fëmijëve Altenmarkt

Zauchenseestraße 3, 5541 Altenmarkt

Tel. +43 (6452) 7331,

[kindergarten@altenmarkt.at](mailto:kindergarten@altenmarkt.at)

## Përkujdes ditor Altenmarkt

Michael-Walchhofer-Straße 8, 5541 Altenmarkt

Tel. +43 (6452) 20875,

[tagesbetreuung@altenmarkt.at](mailto:tagesbetreuung@altenmarkt.at)

## Përmbajtja:

<b>1. Pranimi në kopësht</b> .....	<b>2</b>
1.1. Regjistrimi .....	2
1.2. Pranimi përgjithësisht në kopësht .....	2
1.3. Përrjashtimi nga frekuentimi i mëtejshëm i kopshtit .....	2
1.4. Pranimi i fëmijëve me nevojë të madhe për ndihmë .....	3
<b>2. Grupet e kopshtit dhe orari i hapjes</b> .....	<b>3</b>
2.1. Viti për kopsht .....	3
2.2. Grupet dhe koha e përkujdesit, volumi i përkujdesit .....	3
2.3. Koha e pushimit në institucion .....	3
2.4. Shërbimi në gatishmëri .....	4
<b>3. Dorëzimi dhe marrja e fëmijës</b> .....	<b>4</b>
<b>4. Guzhina për drekën</b> .....	<b>4</b>
<b>5. Autobusi i kopshtit</b> .....	<b>4</b>
<b>6. Kuota për kopësht, autobus dhe ushqim</b> .....	<b>5</b>
6.1. Kuota e përgjithshme për kopsht .....	5
6.2. Kuota për kopësht në rast sëmundjeje apo pushimi të fëmijës .....	5
6.3. Regjistrimi apo çregjistrimi gjatë vitit të kopshtit .....	6
6.4. Kuota e kopshtit gjatë pushimeve verore shkollore .....	6
6.5. Zbritja nga motër apo vëlla .....	6
6.6. Kuota për autobus .....	6
6.7. Kuota për ushqim .....	6
<b>7. Çregjistrimi, mungesa dhe përjashtimi i fëmijëve</b> .....	<b>6</b>
7.1. Çregjistrimi i fëmijës .....	6
7.2. Mungesa e fëmijës .....	7
7.3. Sëmundjet .....	7
<b>8. Detyrimi i kopshtit për mbikqyrje</b> .....	<b>7</b>
<b>9. Dispozitat përfundimtare</b> .....	<b>7</b>

## 1. Pranimi në kopësht

### 1.1. Regjistrimi

Për frekuentimin e kopshtit fëmijët regjistrohen në bordin drejtues të kopshtit, përkatësisht të përkujdesit ditor personalisht përmes prindërve apo personave me të drejtë kujdestarie, duke përdorur formularin e parashikuar për këtë.

### 1.2. Pranimi përgjithësisht në kopësht

Marktgemeinde pranon në kopësht të gjithë fëmijët me banim kryesor në Altenmarkt, për aq sa lejon volumi hapësinor dhe organizator. Përpara vendimit për pranim bordi drejtues i kopshtit shpreh mendimin e tij dhe bën një propozim renditjeje.

Në pamundësi të regjistrimit të të gjithë fëmijëve në kopësht, atëherë në themel për pranim do të vihet renditja sa vijon:

- ⇒ Fëmijët, të cilët vendbanimin kryesor e kanë në Altenmarkt;
- ⇒ Fëmijët, të cilët janë pranë afër moshës së tyre për të hyrë në shkollë;
- ⇒ Fëmijët, tek të cilët, për arsye sociale apo edukative apo për arsye të nevojës së madhe për mbështetje është e përshtatshme mundësia e frekuentimit të kopshtit;
- ⇒ Fëmijët, të cilët kanë frekuentuar më parë kopshtin, ose motrat apo vëllezërit e tyre;
- ⇒ Fëmijët nga komunitetet e tjera do të pranohen sipas kriterit të vendeve të lira;

Për frekuentimin e kopshtit fëmija ka nevojë:

- ✓ Këpucë shtëpie (çanta të holla supi janë të pranishme);
- ✓ Kutitë për futjen e bukës me ushqim të shëndetshëm – luteni të mos fusni ëmbëlsira!
- ✓ Rroba të rehatshme për lëvizje fizike – luteni të jenë të pajisura me emrin;
- ✓ Fëmijët duhet të jenë të veshur në përputhje me kushtet në kopësht dhe motin. Në çdo moment do të jenë të mundurs dalja jashtë dhe shëtitjet;

### 1.3. Përrjashtimi nga frekuentimi i mëtejshëm i kopshtit

Pas dëgjimit të bordit drejtues të kopshtit nga frekuentimi i kopshtit do të përrjashtohen:

- ⇒ Fëmijët, ku për arsye serioze të tyre ekziston frika e dëmtimit të fëmijëve të tjerë apo të institucionit të kopshtit (psh. në aspektin social, moral, higjienik), por vetëm pas marrjes së raportit specialistik të doktorit specialist dhe/apo nga perspektiva e konsultimit për familje dhe edukim.
- ⇒ nëse lihet pas dore në mënyrë të përrsëritur dorëzimi dhe marrja në mënyrë të rregullt;
- ⇒ nëse fëmija do të mungojë për më tepër se dy javë apo në mënyrë të përrsëritur pa arsye;
- ⇒ nëse tarifa e kopshtit nuk do të paguhet për më gjatë se tre muaj dhe që për këtë nuk do të ekzistojnë arsye të rënda;
- ⇒ nëse nuk do të respektohet rregullorja e kopshtit;

## 1.4. Pranimi i fëmijëve me nevojë të madhe për ndihmë

Kusht për ndihmën e veçantë pedagogjike përmes kopshtit, psh.: për shkak të aftësisë së kufizuar, është raporti përkatës specialistik. Kjo mund të merret në konsultimin për familje dhe edukim të landit Salzburg. Formularin ju do t'a merrni në kopësht.

## 2. Grupet e kopshtit dhe orari i hapjes

### 2.1. Viti për kopshtit

Viti për kopshtin fillon të hënën e 2-të në shtator të çdo viti dhe përfundon të djelën përpara fillimit të vitit të ri të kopshtit në vitin në vazhdim. Në përkujdesin ditor faza e ambientimit fillon tashmë një javë më herët se kopshti.

### 2.2. Grupet dhe koha e përkujdesit, volumi i përkujdesit

Në kopësht janë krijuar këto grupe:

- ⇒ Kopësht i rregullt për fëmijët e moshave nga 3-6 vjeç Hënë - Premte, ora 07.00 – 16.30
- ⇒ Grupmosha të avancuara nga 1-5 vjeç Hënë - Premte, ora 07.00 – 16.30
- ⇒ Grupmosha e fëmijëve që ecin këmba-dore nga 1-3 vjeç Hënë - Premte, ora 07.00 – 16.30

Grupet e bashkuara krijohen deri në orën 7.30, duke filluar nga dreka dhe gjatë kohës së lirë nga shkolla (në shkollat e detyrueshme). Në rast nevojë për të paktën 5 fëmijë orari i hapjes së grupit është i mundur deri në orën 17.00.

Koha e rregullt për përkujdesin arrin maksimalisht në 40 orë në javë. Volumi më i lartë i përkujdesit mund të tejkalohet vetëm me përjashtime, në rast se ky në rast të veçantë është në të mirë të fëmijës.

Gjatë pushimeve verore kopshti qëndron i mbyllur për pesë javë dhe përkujdesi ditor për katër javë. Por ekziston mundësia e përkujdesit për të gjithë fëmijët të moshës mbi tre vjeç përmes kooperimit me kopshtin Radstadt. Informacionet dhe regjistrimet i jep drejtoresha e kopshtit.

Të gjithë fëmijët duhet të kalojnë të paktën pesë javë të plota pushimi larg kopshtit për çdo. Në to nuk llogariten mungesat për shkak të sëmundjes.

### 2.3. Koha e pushimit në institucion

Kopshti qëndron i mbyllur:

- ⇒ të shtunave, të djelave dhe në ditët e festave shtetërore;
- ⇒ në ditën e të vdekurëve;
- ⇒ gjatë pushimeve shkollore të detyrueshme gjatë festave të krishtlindjes, duke përfshirë datën 23 dhjetor, në rast se kjo bie ditë e hënë;
- ⇒ dhe gjatë pushimeve të shkollës në arsimin e detyrueshëm në kohën e pashkëve;
- ⇒ për 5 javë (kopësht) përkatësisht 4 javë (përkujdes ditor) gjatë pushimeve verore;

## 2.4. Shërbimi në gatishmëri

Në kohën e pushimit gjatë festave të pashkëve dhe krishtlindjeve përkujdesi ditor është i hapur vetëm për fëmijë, që prindërit e tyre janë në punë. Gjatë kësaj kohe krijohet një shërbim në gatishmëri me kohë veprimi normal vetëm pas dokumentimit përkatës. Paraqitjen e nevojës e trajton drejtoresha në kohën e duhur. Nevoja ekziston atëherë, kur në kohën e pushimit të institucionit regjistrohen të paktën pesë fëmijë me qëllim përkujdesi. Regjistrimi, pjesmarrja dhe pagesa e tarifës janë të detyrueshme për të gjithë periudhën e shërbimit në gatishmëri.

## 3. Dorëzimi dhe marrja e fëmijës

Fëmijët duhet të dorëzohen personalisht tek pedagogja përgjegjëse e fëmijëve (duke filluar nga ora 7.00), jo më vonë se ora 08.30. Fëmijët duhet të merren sipas grupit:

- Përkujdesi me orar të reduktuar, ora 11:30 – 12:30
- Përkujdesi me orar të reduktuar me drekën (3/4 përkujdes), ora 12:30 – 14:00
- Përkujdesi për gjithë ditën: ora 14.00 deri 17:00

Autorizimi për marrjen e fëmijës nga persona të tjerë përveç personave me të drejtë kujdestarie duhet të dëshmohet nga një deklaratë miratimi me shkrim.

Ky person duhet të jetë në gjëndje nga ana mendore dhe fizike, që të ushtrojë mbikqyrjen e fëmijës në mënyrë efektive dhe të jetë të paktën 14 vjeç. Mund të jepen maksimalisht 4 persona të autorizuar për marrjen (përveç prindërve).

## 4. Guzhina për drekën

Guzhina e drekës në kopësht përkujdesin ditor qëndron në dispozicion për fëmijët me 3/4 përkujdes dhe përkujdes të plotë. Marrja e ushqimit bëhet afërsisht në orën 11:45. Kjo kohë quhet si koha e kopshtit.

Regjistrimi, përkatësisht regjistrimi për drekë duhet të bëhet tek bordi drejtues i kopshtit secilën herë jo më vonë se dita e premte e javës së mëparshme deri në orën 09:00 përmes personin me të drejtë kujdestarie.

## 5. Autobusi i kopshtit

Autobusi i kopshtit qëndron në dispozicion për të gjithë fëmijët e rregullt të kopshtit, duke filluar nga java e dytë e kopshtit. Orari i nisjes dhe mbrërritjes do të bëhet i ditur në javën e parë.

Nuk ekziston ndonjë detyrim i komunës Marktgemeinde.

Koha e udhëtimit me autobus nuk llogaritet si kohë e kopshtit. Megjithatë komuna Marktgemeinde vë në dispozicion personelin kujdestar në masën e parashikuar ligjërisht.

Fëmijët duhet të shoqërohen në mëngjes deri tek autobusi, përkatësisht stacionet e hipjes dhe në drekë të merren. Personat me të drejtë marrjeje duhet të jenë të paktën të moshës 14 vjeç.

## 6. Kuota për kopësht, autobus dhe ushqim

Kuotat për kopësht, autobus dhe ushqim të personave me të drejtë kujdestarie caktohen çdo vit nga përfaqësia e komunës dhe publikohen në tabelën zyrtare, në kopësht si edhe në faqen [www.altenmarkt.at](http://www.altenmarkt.at) të internetit.

Këto kuota tërhiqen vetëm me urdhër debiti nga ana e komunës Marktgemeinde Altenmarkt. Autorizimi përkatës i personave me të drejtë kujdestarie duhet të nënshkruhet përmes formularit, së bashku me dokumentacionin për regjistrim të fëmijës suaj.

### 6.1. Kuota e përgjithshme për kopsht

Kuota e përgjithshme për kopësht i shërben sigurimit të një vendi në kopësht dhe sigurimit të shërbimit të përkujdesit.

Kuota mujore nga shtatori deri në qershor duhet paguar secila në fillim të muajit kalendarik. Volumi i përkujdesit llogaritet konform regjistrimit.

Kopshti duhet të përmbushë detyrën ligjore të arsimimit, prandaj si bazë më e ulët këtu vlen përherë përkujdesi i me orar të reduktuar (20 orë) paraditeve, nga e hëna në të premte. Orët suplementare të përkujdesit pasdite llogariten konform regjistrimit.

Për përkujdesin ditor gjatë regjistrimit do të jepen orët përkatësisht ditët e dëshiruara për përkujdesje. Volumi i përkujdesit llogaritet në përputhje me regjistrimin. Volumi minimal është përkujdesi me orar të reduktuar.

Reduktimi i volumit të përkujdesit bazuar në regjistrim është i mundur pas gjysëm simestri. Në kuotë nuk përfshihen vizitat në teatër, ekskursionen, teatri i kukllave, shfaqjeve magjike, ushqimi i drekës, etj., si edhe përkujdesi gjatë pushimeve dhe kuota vjetore për punë dore. Për fëmijë me nevojë të madhe për mbështetje nuk llogaritet kuotë e veçatë.

### 6.2. Kuota për kopësht në rast sëmundjeje apo pushimi të fëmijës

Kuota e kopshtit i shërben sigurimit të një vendi në kopësht dhe sigurimit të shërbimit të përkujdesit, prandaj ulja e kuotës në rast sëmundjeje apo pushimi nuk është e mundur.

### 6.3. Regjistrimi apo çregjistrimi gjatë vitit të kopshtit

Në rast regjistrimi apo çregjistrimi të fëmijës duhet paguar e gjithë kuota e përgjithshme e kopshtit për secilin muaj kalendarik.

#### **6.4. Kuota e kopshtit gjatë pushimeve verore shkollore**

Kuota e kopshtit gjatë pushimeve verore shkollore për shkollat e detyruara është një kuotë mujore dhe shërben për siguriin e një vendi në kopsht dhe për sigurimin e shërbimit të përkujdesit. Në rast regjistrimi për përkujdesje gjatë periudhës së pushimeve kjo është e detyrueshme dhe kjo llogaritet edhe në rast mungese. Ndihamë e landit për fëmijët në vitin e fundit përpara fillimit të shkollës është e vlefshme vetëm për vitin shkollor dhe si rezultat hiqet për muajin korrik dhe gusht. Shërbimi në gatishmëri në ditët e pushimit nga shkolla gjatë ditëve të festave të krishtilindjeve dhe të pashkëve llogaritet me një tarifë të veçantë ditore.

#### **6.5. Zbritja nga motër apo vëlla**

Në rast se kopshti, përkatësisht përkujdesi ditore frekuentohet nga dy apo më tepër fëmijë të një familjeje, atëherë nga komuna Marktgemeinde sigurohet një zbritje prej 40% e kuotës së fëmijës më të vogël (kjo nuk vlen nëse fëmija më i madh është në vitin e fundit të kopshtit). Por përpara zbritjes do të hiqen kompensimet nga kuota e prindërve e federatës dhe/apo landit.

#### **6.6. Kuota për autobus**

Kuota për autobus është vetëm një kuotë mujore (për çdo fillim muaji) dhe mund të llogaritet për udhëtim të thjeshtë apo për shkuarje dhe kthim.

#### **6.7. Kuota për ushqim**

Kuota për ushqimin e drekës është një kuotë ditore dhe llogaritet pas kësaj me llogarinë mujore. Ushqimi që nuk është çregjistruar në kohë do të llogaritet.

### **7. Çregjistrimi, mungesa dhe përjashtimi i fëmijëve**

#### **7.1. Çregjistrimi i fëmijës**

Frekuentimi i kopshtit duhet të bëhet rregullisht. Parimisht fëmijët duhet të regjistrohen për të gjithë vitin e kopshtit. Një regjistrim i plotë për frekuentim të kopshtit do të bëhet vetëm me miratimin e bordit drejtues të kopshtit dhe bëhet vetëm në fund të muajit. Kuotat e paguara nuk kthehen mbrash.

#### **7.2. Mungesa e fëmijës**

Mungesa e fëmijës duhet t'i njoftohet menjëherë bordit drejtues të kopshtit. Drejtoreshës i lejohet, që vendin e kopshtit në rast mungese të gjatë pa arsye t'ia japë dikujt tjetri.

### 7.3. Sëmundjet

Gjatë regjistrimit duhet të jepen të gjitha sëmundjet e fëmijës, qofshin këto të natyrës psikike apo fizike.

Paraqitja e një sëmundjeje infektive të fëmijës duhet t'i njoftohet menjëherë bordit drejtues të fëmijës. Ndalohet frekuentimi i mëtejshëm i kopshtit. E njëjta gjë vlen edhe për fëmijë, që kanë zënë morra. Me qëllim për të mbrojtur fëmijët e tjerë, nuk lejohet që fëmijët me simptoma të dukshme sëmundjeje (si psh.: kolla, rrufa e fortë, e kështu me rradhë) të frekuentojnë kopshtin gjatë kohës së sëmundjes.

## 8. Detyrimi i kopshtit për mbikqyrje

Gjatë përmbushjes së detyrave të tij kopshti ka edhe detyrimin për mbikqyrje të fëmijëve (detyrimi për mbikqyrje).

Detyrimi për mbikqyrje fillon me dorëzimin e fëmijës në kujdestari të një personi kujdestar në autobusin e kopshtit apo në territorin e kopshtit. Ky përfundon me momentin, kur fëmijët merren nga kopshti nga personat me të drejtë kujdestarie apo të autorizuarët e tyre. Detyrimi për mbikqyrje ekziston edhe jashtë territoreve kushtuar kopshteve, për aq kohë sa fëmijët janë në mbrojtje të një pedagogeje fëmijësh, të një asistenteje apo ndihmëseje. Detyrimi për mbikqyrje nuk është i pranishëm, në rast se fëmijët gjenden të shoqëruar nga prindërit e tyre apo persona të tjerë të autorizuar për edukim.

## 9. Dispozitat përfundimtare

Kjo rregullore e kopshtit është e vlefshme për kopshtin dhe përkujdesin ditore Altenmarkt. Tek të gjitha emërtimet në lidhje me personat në këtë rregullore, forma e zgjedhur vlen për të dyja gjinitë. Tek „prindërit“ në kuptim të rregullores kuptohen edhe persona të tjerë me të drejtë kujdestarie.

Prindërit si edhe personat në përkujdesje të fëmijëve janë të detyruar të sillen konform dispozitave të kësaj rregulloreje të kopshtit, si dhe të jë rregullore të mundshme të shtëpisë, përkatësisht konceptit pedagogjik të institucionit.

Kjo rregullore e kopshtit ekziston në shumë gjuhë në bordin drejtues të kopshtit. Në rast të një mospërputhjeje përparësi ka versioni gjerman.

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është ligji mbi përkujdesin e fëmijëve në Salzburg.

Vendim i përfaqësisë së komunës i datës 17.02.2016



Kryetari i Bashkisë:

Rupert Winter